



STATUT

I

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

« IllyriaX Innovation » Sh.p.k.

Sot, në Laç, më 07.07.2025 (dymijë e njëzet e pesë), u paraqitën palët e mëposhtme:

1. **Davide FAZZOLARI**, shtetas italian, lindur në Carmagnola (TO), Itali, më 25.08.1981, banues në Torino (TO), në Villastellone (TO), Via Madonna 13, CAP 10029, i identifikuar nëpërmjet Kartës së Identitetit n.CA34508CX, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Tel: 00393474183048 dhe Email: davidefazzolari@gmail.com, sipërmarrës;
2. **ENJOY SRL**, shoqëri e të drejtës italiane, e regjistruar në Dhomën e Tregtisë të Torinos, me kod tatimor 13146390011, me seli të regjistruar në Torino (TO), Piazza Solferino 20 CAP 10121, e përbërë nga ortakët i vetëm KODRI shoqëri e thjeshtë sipas ligjit italian, e regjistruar në Dhomën e Tregtisë të Torinos, me kod tatimor 97908090018, me seli të regjistruar në Torino (TO), Piazza Solferino 20 CAP 10121, me ortakët përkatës: Alberto CODRINO, ortak administrator me 90% kapitalit të shoqërisë, Denis CODRINO, ortak me 10% të kapitalit të shoqërisë, Chiara BERGAMASCO ortakë pune me 0% të kapitalit të shoqërisë dhe Riccardo BERTOLA ortak pune me 0% të kapitalit të shoqërisë, të dyja shoqëritë të përfaqësuara sipas Procesverbalit të Mbledhjes së Zakonshme të Ortakëve të 4 Qershorit 2025 nga Administratori **Alberto CODRINO**, shtetas italian, i lindur në Torino (TO), Itali, më 01.11.1959, banues në Torino (TO), në Corso Regio Parco, N.5/A, Torino (TO), CAP 10152, i identifikuar me Kartë Identiteti nr. CA02462TM, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Tel: 00393483669393 dhe Email: alberto.codrino.59@gmail.com, sipërmarrës;
3. **Vincenzo GRASSO**, shtetas italian, lindur në Lentini (SR), Itali, më 25.03.1973, banues në Torino (TO), Via Caraglio 113/6/C, CAP 10141, i identifikuar me Kartë Identiteti nr.AX5856789, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Tel:00393495231363 dhe Email: grasso.vincenzo@gmail.com, sipërmarrës;
4. **Ezio ORMEZZANO**, shtetas italian, lindur në Torino (TO), Itali, më 08.10.1965, banues në Torino (TO), Via Cesare Lombroso 25, CAP 10125, i identifikuar me Kartë Identiteti nr.CA40837AY, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Tel:00393358192433 dhe Email: ezio.ormezzano@gmail.com, sipërmarrës;
5. **Klajd DIKO**, shtetas shqiptar, lindur në Durrës, Shqipëri, më 21.03.1991, banues në Tiranë, Rruga "Frank Bardhi", i identifikuar me Kartë Identiteti nr.J10321083U, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Tel:0693653641 dhe Email: klajd.diko@gmail.com, sipërmarrës;
6. **Marsel PIROLI**, shtetas shqiptar, lindur në Krujë, Shqipëri, më 23.09.1995, banues në Tiranë, Rruga "Panajot Pano", i identifikuar me Kartë Identiteti nr.J50923118D, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Tel:0685359893 dhe Email: marseli.pirol@gmail.com, sipërmarrës.

Të cilët vendosën të nënshkruajnë Statutin e mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe nga ky Statut.

KAPITULLI I FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA

Neni 1 – Forma

- 1.1. Shoqëria "IllyriaX Innovation" Sh.p.k. (në vijim "Shoqëria") krijohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Statuti dhe nga legjislacioni në fuqi.
- 1.2. Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 1.3. Statuti i shoqërisë është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe ka karakter të detyrueshëm për nënshkruesit e tij, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në të, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

Neni 2 – Emërtimi

- 2.1. Emërtimi i Shoqërisë është "IllyriaX Innovation" Sh.p.k.

Neni 3 – Objekti i shoqërisë

- 3.1 Shoqëria operon në sektorin e konsulencës së teknologjisë së informacionit dhe prodhimit të softuerëve; në veçanti, qëllimi i shoqërisë janë aktivitetet e mëposhtme:
 - prodhimi dhe tregtimi i shërbimeve dhe produkteve të teknologjisë së informacionit të aplikuara në çdo sektor ekonomik, prodhues dhe të burimeve njerëzore;
 - konsulencë menaxheriale për organizimin dhe proceset e biznesit (konsulencë menaxheriale, këshillim biznesi);
 - konsulencë për përmirësimin e zhvillimit të produktit dhe proceseve të prodhimit;
 - "transformim dixhital" (d.m.th. përmirësimi dhe riorganizimi i metodave të funksionimit të kompanisë falë përdorimit të përhapur dhe të integruar të teknologjive të informacionit dhe telekomunikacionit);
 - studimi dhe zbatimi i sistemeve të informacionit teknologjik në shkallë të gjerë të lidhur me organizimin, menaxhimin e aktivitetëve ekonomike, proceset e projektimit industrial dhe profesional dhe inxhinierinë e prodhimit, duke përfshirë aktivitetet e përpunimit të të dhënave edhe në emër të palëve të treta, duke përfshirë shërbimet e mbajtjes në internet, arkivimin, rikuperimin e të dhënave nga ngjarje të dëmshme ose aksidentale dhe transmetimin e të dhënave;
 - marketingun, shpërndarjen, dhënien me qira, ofrimin e shërbimeve, si dhe mirëmbajtjen, personalizimin e sistemeve harduerike dhe çdo gjëje tjetër të lidhur, të softuerit dhe çdo gjëje tjetër të lidhur, të licencave, si në emër të tij ashtu edhe në emër të palëve të treta;
 - studimin, projektimin dhe ndërtimin e harduerit të shoqërisë dhe rrjeteve të telekomunikacionit;
 - ushtrimin e përfaqësimit në emër të shoqërive dhe organizatave të të gjitha llojeve, si vendase ashtu edhe të huaja, për shitjen, koncesionin, dhënien me qira dhe licencimin e përdorimit të produkteve harduerike dhe softuerike siç specifikohet më sipër;
 - organizimin dhe menaxhimin e të gjitha aktivitetëve që lidhen me pikat e mëparshme dhe në veçanti aktivitetet e trajnimit, përgatitjen e burimeve njerëzore, duke përfshirë organizimin dhe menaxhimin e ngjarjeve trajnuese si konferenca dhe seminare si në Itali ashtu edhe jashtë saj



- 3.2 Shoqëria gjithashtu mund të marrë dhe të japë agjenci, përfaqësime dhe mandate, si dhe të kryejë transaksione tregtare, financiare, të luajtshme dhe të paluajtshme në çfarëdo mënyre të përshtatshme për qëllimin e shoqërisë dhe të dobishme për arritjen e të njëjtit qëllim, duke përfshirë lëshimin e garancive reale dhe personale. Ndalohen rreptësisht operacionet që përfshijnë mbledhjen dhe kërkimin e kursimeve nga publiku, si dhe ato ~~aktivitete~~ financiare që kërkojnë regjistrim në regjistra ose lista të veçanta ose ekzistencën e kërkesave të veçanta.
- 3.3 Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të shoqërisë sipas nenit 3.1 më lart.

Neni 4 – Selia

- 4.1 Selia e shoqërisë do të jetë në adresën: Innospace Tirana, Rruga "Pjeter Bogdani", Pallati 10, Hyrja 5, Kati 7, ZK 8270, Pasuria 3/60+1-32 1019.
- 4.2 Transferimi i selisë së Shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendimin e Asamblesë së Ortakëve.
- 4.3 Asambleja e Ortakëve vendos për hapjen e filialeve, adresave dytësore, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë saj.
- 4.4 Asambleja e Ortakëve mund t'ia delegojë këto kompetenca organit administrativ.

Neni 5 – Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 5.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat të pakufizuar.
- 5.2 Shoqëria mund të prishet përpara këtij afati ose mund të zgjasë kohëzgjatjen e saj me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

KAPITULLI II KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE

Neni 6 – Kapitali themeltar

- 6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lekë.
- 6.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 6 (gjashtë) kuota, të gjitha të nënshkuara me vlerë nominale sipas kontributit të ortakëve në kapitalin themeltar të Shoqërisë përcaktuar në nenin 7 (shtatë) të këtij Statuti.

Neni 7 – Kontributet

- 7.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si më poshtë:
- **Davide FAZZOLARI** ofron një kontribut në para të barabartë me 20.000 ALL (njëzetmijë lekë), nëpërmjet depozitimit të kësaj shume pranë llogarisë bankare në emër të shoqërisë në themelim e sipër;
 - **ENJOY SRL**, ofron një kontribut në para të barabartë me 20.000 ALL (njëzetmijë lekë), nëpërmjet depozitimit të kësaj shume pranë llogarisë bankare në emër të shoqërisë në themelim e sipër;



- **Vincenzo GRASSO**, ofron një kontribut në para të barabartë me 20.000 ALL (njëzetmijë lekë), nëpërmjet depozitimit të kësaj shume pranë llogarisë bankare në emër të shoqërisë në themelim e sipër;
 - **Ezio ORMEZZANO**, ofron një kontribut në para të barabartë me 20.000 ALL (njëzetmijë lekë), nëpërmjet depozitimit të kësaj shume pranë llogarisë bankare në emër të shoqërisë në themelim e sipër;
 - **Klajd DIKO**, ofron një kontribut në para të barabartë me 10.000 ALL (dhjetëmijë), nëpërmjet depozitimit të kësaj shume pranë llogarisë bankare në emër të shoqërisë në themelim e sipër;
 - **Marsel PIROLI**, ofron një kontribut në para të barabartë me 10.000 ALL (dhjetëmijë), nëpërmjet depozitimit të kësaj shume pranë llogarisë bankare në emër të shoqërisë në themelim e sipër.
- 7.2 Sipas kontributeve të mësipërme:
- Ortakut **Davide FAZZOLARI**, i përket një kuotë me vlerë nominale 20.000 ALL (njëzetmijë lekë), që i korrespondon 20% (njëzet përqind) të kapitalit të Shoqërisë;
 - Ortakut **ENJOY SRL**, i përket një kuotë me vlerë nominale 20.000 ALL (njëzetmijë lekë), që i korrespondon 20% (njëzet përqind) të kapitalit të Shoqërisë;
 - Ortakut **Vincenzo GRASSO**, i përket një kuotë me vlerë nominale 20.000 ALL (njëzetmijë lekë), që i korrespondon 20% (njëzet përqind) të kapitalit të Shoqërisë;
 - Ortakut **Ezio ORMEZZANO**, i përket një kuotë me vlerë nominale 20.000 ALL (njëzetmijë lekë), që i korrespondon 20% (njëzet përqind) të kapitalit të Shoqërisë;
 - Ortakut **Klajd DIKO**, i përket një kuotë me vlerë nominale 10.000 ALL (dhjetëmijë lekë), që i korrespondon 10% (njëzet përqind) të kapitalit të Shoqërisë;
 - Ortakut **Marsel PIROLI**, i përket një kuotë me vlerë nominale 10.000 ALL (dhjetëmijë lekë), që i korrespondon 10% (njëzet përqind) të kapitalit të Shoqërisë.
- 7.3 Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme ose të drejta).

Neni 8 – Rritja e kapitalit themeltar

- 8.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Ortakëve.
- 8.2 Rritja e kapitalit bëhet me vendimin të Asamblesë së Ortakëve, kur votohet pro me $\frac{3}{4}$ e tërësisë së votave të Asamblesë së Ortakëve.
- 8.3 Vendim i vlefshëm merret vetëm nëse ortakët janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 8.4 Në rast rritjeje të kapitalit, të gjithë ortakët kanë të drejtën të nënshkruajnë rritjen në raport me vlerën nominale të kuotës së kapitalit të zotëruar. Në rast se disa nga ortakët nuk e ushtrojnë këtë të drejtë, pjesët e tyre mund të nënshkruhen nga ortakët e tjerë proporcionalisht me vlerën nominale të kuotës së kapitalit të zotëruar prej tyre.
- 8.5 Zmadhimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve në proporcion me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre.

9








Neni 9 – Zvogëlimi i kapitalit themeltar

- 9.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendim me 3/4 të Asamblesë së Ortakëve. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
- 9.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve në të njëjtën masë me vlerën nominale të kuotës së kapitalit të zotëruar prej tyre.

Neni 10 – Transferimi i kuotave

- 10.1 Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen lirisht midis ortakëve me anë të aktit inter vivos dhe mund të fitohen ose kalohen me anë të:
- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - d) dhurimit;
 - d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.
- Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata për kalimin e kuotës hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë, vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.
- 10.2 Në rast transferimi në çdo lloj forme, si me shpërblim ashtu edhe pa shpërblim në kuptimin më të gjerë të fjalës, duke përfshirë këtu edhe dhurimin në favor të subjekteve të tjerë të ndryshëm nga ortakët, kuotat duhet më parë t'i ofrohen në parablerje ortakëve të tjerë në kushte të barabarta.
- 10.3 Në një rast të tillë ortakët që do të transferojë kuotën e tij duhet të njoftojë ortakët e tjerë, me letër rekomande me kthim përgjigje dhe/ose me Letër Njoftimi nëpërmjet postës elektronike (në vijim "Njoftimi"), mbi synimin për shitje, duke përcaktuar çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e blerësit dhe kushtet e transferimit. E drejta e parablerjes duhet t'i referohet të gjithë kuotës të ofruar për shitje.
- 10.4 Ortakët do të kenë në dispozicion 3 (tre) muaj nga marrja e Njoftimit, për t'i komunikuar ortakut që transferon kuotat, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, presumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.
- 10.5 Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, kuota e ofruar nga ortakët që transferon kuotën, do të ndahet midis ortakëve pranues, në të njëjtën masë me vlerën nominale të kuotës së kapitalit që ata zotërojnë, përveç rastit kur ka një marrëveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.
- 10.6 Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuotat mund t'u transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendimin pozitiv të Asamblesë së Ortakëve.
- 10.7 Nëse një ose më shumë ortakë vendosin t'u shesin palëve të treta jashtë strukturës së shoqërisë në një zgjidhje të vetme, ose në disa zgjidhje që i atribuohen të njëjtëve pronarë, kuotat e shoqërisë që përfaqësojnë të paktën gjashtëdhjetë për qind të kapitalit të shoqërisë (shumicën), ortakëve të tjerë, pronarë të të paktën pesë për qind të vetë

- kapitalit të shoqërisë (pakicës), u jepet e drejta për t'ia shitur të njëjtës palë të tretë blerëse dhe me të njëjtat kushte të përcaktuara për blerjen e pjesës tjetër, të gjitha ose një pjesë të kuotave të tyre.
- 10.08 Propozimi për blerjen e kuotave të pakicës nuk mund të konsiderohet i përshtatshëm nëse çmimi i blerjes së një kuote të tillë pritet të jetë më i ulët se vlera e tregut në kohën e propozimit; në rast mosmarrëveshjeje përcaktimi bëhet me raport betimi nga një ekspert i caktuar nga gjykata, i cili parashikon edhe shpenzimet, me kërkesë të palës më të zellshme.
- 10.09 Ortakët që synojnë të shesin kuotat e tyre u kërkohej të ofrojnë një ofertë blerjeje të pakthyeshme për nëntëdhjetë ditë në favor të ortakëve të pakicës, për të gjitha ose një pjesë të kuotave të tyre, me të njëjtat kushte të parashikuara për shitjen e kuotave të tyre.
- 10.10 Për të lejuar ushtrimin e së drejtës së bashkë-shitjes, ata duhet t'ua komunikojnë ofertën e blerësit të tretë ortakëve të tjerë me anë të një letre rekomande me kthim përgjigje ose me email brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga marrja e ofertës nga blerësi i palës së tretë.
- 10.11 Ortaku i pakicës duhet t'i komunikojë ofertuesit të tretë pranimin e propozimit me anë të një letre rekomande me kthim përgjigje ose me email, që do t'i dërgohet brenda afatit të ofertës dhe gjithashtu duhet të njoftojë ortakun e shumicës me anë të një letre rekomande me kthim përgjigje ose me email brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga komunikimi i pranimin tek ofruesi.
- 10.12 Pasi të ketë skaduar afati për ofertën e palës së tretë, në mungesë të pranimin nga ortaku i pakicës në mënyrën e treguar, vetë oferta do të konsiderohet e skaduar dhe ortaku i shumicës do të mund t'ia shesë lirisht kuotat e tij palës së tretë.
- 10.13 Vlefshmëria e propozimit për shitjen e kuotave të shumicës kushtëzohet rreptësisht nga pala e tretë që të bëjë një propozim të përshtatshëm për të blerë edhe kuotat e pakicës. Nëse blerësi i palës së tretë nuk synon të blejë të gjithë kapitalin e shoqërisë, kuota e blerë nga pala e tretë do të përbëhet nga një pjesë e kuotave të shumicës dhe një pjesë e pjesëmarrjes së ortakut të pakicës në përpjesëtim me kuotat e zotëruara prej tyre në kapitalin e shoqërisë.
- 10.14 Nëse një ose më shumë ortakë, që përbëjnë shumicën e kapitalit të shoqërisë, vendosin t'ua shesin palëve të treta jashtë strukturës së shoqërisë në një transaksion të vetëm, kuotat që përfaqësojnë të paktën pesëdhjetë e një për qind të kapitalit të shoqërisë, blerësi i tretë ka të drejtë të blejë në të njëjtat kushte edhe kuotat e mbetura në pronësi të ortakëve që përbëjnë pakicën.
- 10.15 Në rast se i treti synon të ushtrojë të drejtën e zvarritjes, duhet të njoftojë organin administrativ dhe të gjithë anëtarët që përbëjnë pakicën me anë të një letre rekomande me kthim përgjigje ose email brenda tridhjetë ditëve; Ky komunikim duhet të përmbajë të dhënat personale të marrësit të transferimit, çmimin e ofruar për blerjen e kuotave të shumicës dhe pakicës dhe kushtet e transferimit. Ortaku që përbën pakicën do të zbatojë sjelljet e nevojshme për të lejuar përfundimin e aktit të vetëm të transferimit.
- 10.16 Për këtë qëllim, ortakut të pakicës do t'i kërkohej të nënshkruajë një marrëveshje depozite dhe të lëshojë një autorizim për shitje.
- 10.17 Kuotat e ortakëve që përbëjnë pakicën nuk mund të shiten me një çmim më të ulët se vlera e tregut në momentin e propozimit; në rast mosmarrëveshjeje përcaktimi bëhet me raport betimi nga ekspert i caktuar nga gjykata e Tiranës.
- 10.18 Në rast mosmarrëveshjeje për përcaktimin e vlerës së kuotave të pakicës, që do të kryhet me anë të një kundërshtimi të njoftuar nga ortaku që i nënshtrohet shitjes tek ortaku transferues, brenda gjashtëdhjetë ditëve nga marrja e ofertës për kuotat e pakicës, vlera e kuotave përcaktohet, brenda nëntëdhjetë nga kundërshtimi, me anë të raportit të betuar

nga një ekspert i caktuar nga gjykata, i cili parashikon edhe shpenzimet, me kërkesë të palës më të zellshme.

- 10.19 Në rast të vdekjes së një ortaku, shoqëria mund të vazhdojë ta ushtrojë veprimtarinë me trashëgimtarët e ortakut të vdekur, nëse pranohet nga trashëgimtarët. Trashëgimtarët mund të ushtrojnë të drejtën e pjesëmarrjes në shoqëri brenda 30 ditëve nga data, që është lëshuar dëshmia e trashëgimisë.
- 10.20 E drejta e tërheqjes është në dispozicion të ortakut në çdo kohë dhe mund të ushtrohet me njoftim të paktën njëqind e tetëdhjetë ditë përpara.
- 10.21 Personi që transferon kuotën dhe personi që e blen atë janë bashkëpërgjegjës ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga pronësia e kuotës, nga momenti i kalimit të kuotës deri në momentin e regjistrimit të kalimit të kuotës.

KAPITULLI III

ASAMBLEJA, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI KONTABËL

Neni 11 – Asambleja e ortakëve dhe kompetencat e saj

- 11.1. Asambleja e Ortakëve është organi vendim-marrës i Shoqërisë.
- 11.2. Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse dhe merr vendim me $\frac{3}{4}$ e votave për çështjet vijuese:
- ndryshimet e statutit,
 - zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit,
 - shpërndarjen e fitimeve,
 - riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë,
- 11.3. Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet vijuese: ndryshimet e statutit, emërimi dhe shkarkimi i administratorëve, audituesve ligjorë e likuidatorëve, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit, transferimi i kuotave, shpërndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqërisë, miratimi i bilancit dhe për çdo vendim tjetër të parashikuar nga ky Statut, apo nga legjislacioni përkatës.

Neni 12 – E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës

- 12.1. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamble, të paraqesë mendimin e tij dhe të japë aq vota në proporcion me vlerën nominale të kuotës së kapitalit që ai zotëron.
- 12.2. Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër jo-ortak, i pajisur me prokurë me shkrim, me anën e së cilës mund të japë votën e tij.
- 12.3. Ortaku nuk mund të lëshojë prokurë për votim për një pjesë të kapitalit që zotëron, në qoftë se voton personalisht për pjesën e mbetur.

Neni 13 – Thirrja e Asamblesë së Ortakëve, Kuorumi dhe Vendimet

- 13.1. Asambleja e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit/ve, dhe/ose audituesit ligjor (nëse është emëruar) si dhe të inventarit.
- 13.2. Asambleja mund të thirret në çdo moment prej Administratorit me iniciativën e tij ose sipas kërkesës që do t'i drejtohet Administratorit nga një ose disa prej ortakëve që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë) përqind të kapitalit themeltar. Asambleja thirret

- nëpërmjet: a) njoftimit me letër rekomandë me kthim përgjigje, b) Postë elektronike në adresën që rezulton sipas këtij Statuti - dhe audituesit ligjor (nëse është emëruar).
- 13.3 Lajmërimi do t'u dërgohet ortakëve jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë. Në rastin e njoftimit me email, përveç periudhës prej 7 ditësh, parashikohet një periudhë shtesë prej 5 (pesë) ditësh kalendarike. Njoftimi për secilin ortak dërgohet në adresat respektive përshkruar në hyrje të këtij akti. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi llojin e Asamblesë, mbi rendin e ditës që do të trajtohet dhe për të cilat do të merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.
- 13.4 Asambleja mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë, me kusht që të jetë në Itali ose në Shqipëri.
- 13.5 Në rast se Asambleja e Ortakëve nuk mbledhet me thirrjen e parë për mungesën e kuorumit, Asambleja e Ortakëve konform ligjit do të thirret brenda 30 (tridhjetë) ditësh me të njëjtin rend dite.
- 13.6 Mbledhjet e Asamblesë mund të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe t'u lejohet atyre të ndjekin diskutimin dhe të ndërhyjnë në momentin e trajtimit të çështjeve në rend të ditës, pasi të jenë verifikuar se këto kërkesa rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes. Asambleja konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari, në të cilin duhet të ndodhet edhe Sekretari i mbledhjes.
- 13.7 Asambleja konsiderohet e mbajtur rregullisht nëse Asambleja mbledhet në selinë e shoqërisë. Asambleja konsiderohet se mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit e të vendmbajtjes në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të tërë kapitalin themeltar.
- 13.8 Vendimet e Asamblesë së Ortakëve, për të cilat kërkohet një shumicë e kualifikuar, përjashtojnë vendimet e parashikuara në nenin 10.2 janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar.
- 13.9 Për drejtimin e punëve në çdo Asamble zgjidhet një Kryetar, ortak ose ndonjë person tjetër jo-ortak i caktuar nga vetë Asambleja. Për pasqyrimin e vendimit Asambleja emëron një Sekretar, që mund të jetë edhe jo-ortak.
- 13.10 Vendimet e Asamblesë duhet të nënshkruhen nga Kryetari i Asamblesë dhe Sekretari.

Neni 14 – Njoftimi

- 14.1 Njoftimi i ndërsjellë ndërmjet Administratorit, Personelit drejtues dhe bashkëpunëtorëve të shoqërisë, do të realizohet nëpërmjet: a) njoftimit me letër rekomandë me kthim përgjigje, b) Postës elektronike; d) njoftimit në faqen zyrtare elektronike të shoqërisë;
- 14.2 Njoftimi me postë elektronike do të konsiderohet i kryer me kalimin e një afati total prej 12 (dymbëdhjetë) ditësh kalendarike nga data e nisjes së Emailit nga njoftuesi. Ky afat përbëhet dhe është shumatore e afatit minimal ligjor prej 7 (shtatë) ditësh dhe afatit prej 5 (pesë) ditësh kalendarike të lënë në dispozicion për konsultim të Emailit.
- 14.3 Njoftimi për secilin ortak dërgohet në adresat respektive përshkruar në hyrje të këtij akti. Administratori, Personeli drejtues dhe bashkëpunëtorët e kontraktuar nga shoqëria duhet të depozitojnë adresën e tyre elektronike në shoqëri.
- 14.4 Njoftimi me email konsiderohet i kryer me kalimin e një afati total prej 12 (dymbëdhjetë) ditësh kalendarike, siç parashikohet në nenin 13.3, më sipër.



Neni 15 – Administrimi

- 15.1. Shoqëria administrohet nga të paktën 1 (një) administrator, i cili do të qëndrojë në detyrë deri në shkarkim, apo dorëheqje për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh. Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim unanim të Asamblesë së Ortakëve.
- 15.2. Administratori ka të drejtën për t'u riemëruar, nëse Asambleja nuk vendos ndryshe para mbarimit të mandatit të administratorit.
- 15.3. Administrator i Shoqërisë do të jetë:
- **Z. Marsel PIROLI**, shtetas shqiptar, lindur në Krujë, Shqipëri, më 23.09.1995, banues në Tiranë, Rruga "Panajot Pano", i identifikuar me Kartë Identiteti nr.J50923118D.
 - Administratori i shoqërisë, **Z. Marsel PIROLI** emërohet për një afat 5 (pesë) vjeçar nga data e nënshkrimit të këtij akti.
- 15.5. Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë i besohet Administratorit. Administratori mund të ushtrojë të gjitha kompetencat në përputhje me nenin 95 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" duke respektuar në çdo rast kufijtë e kufizimet e përcaktuara në këtë statut si edhe në vendime të mëvonshme të Asamblesë së Ortakëve.
- 15.6. Administratori mund të emërojë përfaqësues të posaçëm për veprime apo kategori të caktuara veprimesh.
- 15.7. Kompetencat e Administratorit kufizohen si më poshtë:
- Ka të drejtën të kryejë të gjitha veprimet bankare për çeljen e llogarive të Shoqërisë, në çfarëdo monedhe pranë çdo banke të nivelit të dytë në Shqipëri, duke përfshirë nënshkrimin e kontratave të çeljes së llogarisë dhe plotësimin e çdo dokumenti të nevojshëm e të kërkuar nga Banka për realizimin e këtij qëllimi. Administratori ka të drejtë të kryejë çdo lloj veprimi dhe transaksioni deri në vlerën limit prej 50.000 EUR. Për çdo transaksion mbi këtë vlerë duhet marrë Aprovimi me Vendim i Asamblesë së Ortakëve.
 - Nuk lejohet të nënshkruajë Kontrata të Blerjes dhe Shitjes me furnitorë dhe klientë si dhe nuk lejohet të nënshkruajë Kontrata të Shitjes së aseteve të Shoqërisë dhe angazhimit të saj në huadhënie, që tejkalojnë vlerën limit prej 50.000 EUR.

Neni 16 – Audituesi Ligjor

- 16.1. Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Ortakëve, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë mund t'i besohet një ose disa audituesve ligjorë.
- 16.2. Audituesi Ligjor mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

KAPITULLI IV

VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 17 - Viti financiar dhe bilanci vjetor

- 17.1. Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit.
- 17.2. Viti parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit.
- 17.3. Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe audituesit ligjor miratohen

nga Asambleja me shumicën e kërkuar nga Ligji n.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare".

- 17.4 Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vitit financiar.

Neni 18 – Fitimet

- 18.1 Fitimi i realizuar nga aktiviteti i shoqërisë u takon ortakëve themelues në masën:
- a) Davide FAZZOLARI 20%;
 - b) ENJOY srl 20%;
 - c) Vincenzo GRASSO 20%;
 - d) Ezio ORMEZZANO 20%;
 - e) Klajd DIKO 10%
 - f) Marsel PIROLI 10%.
- 18.2 Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, u shpërndahen ortakëve në proporcion me vlerën nominale të kuotës së kapitalit themeltar të zotëruar.
- 18.3 Asambleja mund të vendosë zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

KAPITULLI V SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Neni 19 – Prishja

- 19.1 Shoqëria priset me përfundimin e afatit të parashikuar nga Statuti, ose përpara përfundimit në rastet e parashikuara nga ligji, ose me anë të një vendimi të Asamblesë së Ortakëve, me shumicën e kërkuar për ndryshimet në statut.
- 19.2 Shoqëria nuk priset në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, vdekjes, ose falimentimit të ortakëve.

Neni 20 – Likuidimi

- 20.1 Në rast prishje, Shoqëria duhet të likuidohet.
- 20.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.
- 20.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja do të vendosë mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.
- 20.4 Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakëve, në proporcion me vlerën nominale të kuotës së zotëruar prej tyre në kapitalin themeltar.

Neni 21 – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 21.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti si dhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç

atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.

- 21.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 22 – Gjuha

- 22.1 Ky Statut është hartuar në 8 (tetë) kopje me të njëjtën vlerë ligjore në gjuhën shqipe me shtojcë përkthimin në gjuhën italiane. Një kopje depozitohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, një kopje për secilin ortak dhe një kopje në Zyrën e Noterisë.
- 22.2 Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin e akteve si më lart, versioni në shqip do të jetë i vetmi version ligjërishit detyrues.

Ky akt u lexua dhe u kuptua nga nënshkruesit të cilët deklarojnë se akti është i rregullt, tërësisht dhe në çdo paragraf në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, japin pëlqimin përsa përmendet në akt dhe nënshkruajnë rregullisht në çdo faqe me emër, mbiemër dhe firmë në mbyllje të aktit.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË TREGTARE "ILLYRIAX INNOVATION" sh.p.k

ENJOY SRL dhe KODRI SS

Përfaqësuar nga

Alberto CODRINO

ALBERTO CODRINO
Alberto Codrino

Vincenzo GRASSO

VINCENZO GRASSO
Vincenzo Grasso

Davide FAZZOLARI

DAVIDE FAZZOLARI
Davide Fazzolari

Ezio ORMEZZANO

EZIO ORMEZZANO
Ezio Ormezzano

Klajd DIKO

Klajd Diko
Klajd Diko

Marsel PIROLI

MARSEL PIROLI
Marsel Piroli

PËRKTHYESE

Aida GJINI

Aida Gjini
Aida Gjini



S T A T U T O
DELLA
SOCIETÀ A RESPONSABILITÀ LIMITATA
« IllyriaX Innovation » Sh.p.k

Oggi, a Laç, il 07 Luglio 2025 (duemilaventicinque), sono presenti le seguenti Parti:

1. **Davide FAZZOLARI**, cittadino italiano, nato a Carmagnola (TO), Italia, il 25.08.1981, residente a Torino (TO), in Villastellone (TO), Via Madonna 13, CAP 10029, identificato con Carta d'Identità n.CA34508CX, maggiore e con piena capacità giuridica di agire, Tel:00393474183048, Email: davidefazzolari@gmail.com, imprenditore;
2. **ENJOY SRL**, società di diritto italiano, iscritta presso la Camera di Commercio di Torino, con numero di iscrizione e codice fiscale 13146390011, con sede legale a Torino (TO), Piazza Solferino 20 CAP 10121, composta dal socio unico KODRI società semplice di diritto italiano, iscritta presso la Camera di Commercio di Torino, con numero di iscrizione e codice fiscale 97908090018, con sede legale a Torino (TO), Piazza Solferino 20 CAP 10121, con i rispettivi soci: CODRINO Alberto, socio Amministratore con 90% del capitale sociale, CODRINO Denis, socio con 10% del capitale sociale, BERGAMASCO Chiara socio di lavoro con 0% del capitale sociale e BERTOLA Riccardo socio di lavoro con 0% del capitale sociale, tutte le due società rappresentate ai sensi del Verbale dell'Assemblea Ordinaria dei Soci del 4 Giugno 2025 dall'Amministratore **Alberto CODRINO**, cittadino italiano, nato a Torino (TO), Italia, il 01.11.1959 residente a Torino (TO), in Corso Regio Parco, N.5/A, Torino (TO), CAP 10152, identificato con Carta d'Identità n.CA02462TM, maggiore e con piena capacità giuridica di agire, Tel:00393483669393, Email: alberto.codrino.59@gmail.com, imprenditore;
3. **Vincenzo GRASSO**, cittadino italiano, nato a Lentini (SR), Italia, il 25.03.1973, residente a Torino (TO), Via Caraglio 113/6/C, CAP 10141, identificato con Carta d'Identità n.AX5856789, maggiore e con piena capacità giuridica di agire, Tel:00393495231363, Email: grasso.vincenzo@gmail.com, imprenditore;
4. **Ezio ORMEZZANO**, cittadino italiano, nato a Torino (TO), Italia, il 08.10.1965, residente a Torino (TO), Via Cesare Lombroso 25, CAP 10125, identificato con Carta d'Identità n.CA40837AY, maggiore e con piena capacità giuridica di agire, Tel:00393358192433, Email: ezio.ormezzano@gmail.com, imprenditore;
5. **Klajd DIKO**, cittadino albanese, nato a Durazzo (Albania) il 21.03.1991, residente a Tirana, Rruga "Frank Bardhi", identificato con Carta d'Identità n.J10321083U, maggiore e con piena capacità giuridica di agire, Tel:0693653641, Email: klajd.diko@gmail.com, imprenditore;
6. **Marsel PIROLI**, cittadino albanese, nato a Krujë, Albania, il 23.09.1995, residente Tirana, Rruga "Panajot Pano", identificato con Carta d'Identità n.J50923118D, maggiore e con piena capacità giuridica di agire, Tel:0685359893, Email: marseli.piroli@gmail.com, imprenditore;

Le quali hanno deciso di stipulare il seguente Statuto di una società a responsabilità limitata, la cui attività verrà regolata dalla legislazione Albanese in vigore e dallo presente Statuto.

      6

CAPITOLO I
FORMA, DENOMINAZIONE, OGGETTO, SEDE, DURATA

Articolo 1 – Forma

- 1.1. La Società "IllyriaX Innovation" Sh.p.k (d'ora in avanti la "Società") è costituita in forma di società a responsabilità limitata, ed è regolata dal presente Statuto e dalla legislazione in vigore;
- 1.2. La Società opera secondo la legislazione albanese in vigore.
- 1.3. Lo statuto della Società è conforme alla normativa albanese a carattere inderogabile ed è integrato, per quanto in essi non espressamente previsto, dalla legislazione albanese.

Articolo 2 – Denominazione

- 2.1. La denominazione della Società è "IllyriaX Innovation" Sh.p.k.

Articolo 3 – Oggetto sociale

- 3.1 La società opera nel settore della consulenza delle tecnologie informatiche e della produzione di software; in particolare la società ha per oggetto le seguenti attività:
 - la produzione e la commercializzazione di servizi e prodotti delle tecnologie informatiche applicati ad ogni settore economico produttivo e delle risorse umane;
 - consulenza direzionale sull'organizzazione ed i processi aziendali (management consulting, business consulting);
 - consulenza sul miglioramento dei processi di sviluppo prodotto e di produzione;
 - "digital transformation" (ovvero il miglioramento e l'efficientamento delle modalità di operare dell'azienda grazie all'uso pervasivo ed integrato delle tecnologie informatiche e di telecomunicazione);
